



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 206/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.05.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

**Objekt:**

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Erzeni Sh” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me nr. REF-87615-02-18-2021, me objekt “Blerje pajisje për shkolla kopshte” me fondin limit : 20’832’000 Lekë pa TVSH , zhvilluar në datën 16.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Murati D” SHPK. në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

**Ankimues:**

“Erzeni Sh” SHPK.

Lagjia “Bahçallek” Rruga nacionale Shkodër- Tiranë, Shkodër

“Emko” SHPK.

Rruga: “Teodor Keko”, Unaza e Re, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Durrës

Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës

**Subjekt i Interesuar:**

“Murati D” SHPK.

Lagjja: “Kryengritja e Fierit”, Rruga “Aulona”, Fier

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.02.2021, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me nr. REF-87615-

02-18-2021, me objekt “Blerje pajisje për shkolla kopshte” me fondin limit : 20’832’000 Lekë pa TVSH , zhvilluar në datën 16.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 16.03.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 09.04.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ERZENI/SH” SHPK.	15.367.000 lekë, skualifikuar
2. “Murati D” SHPK.	15.458.625 lekë, kualifikuar
3. “E M K O” SHPK.	16.105.200 lekë, kualifikuar
4. “ERVIN LUZI” p.f.	17.400.000 lekë, skualifikuar
5. “SHAGA.” SHPK.	18.657.870 lekë, kualifikuar
6. “RO -AL” SHPK.	18.900.920 lekë, skualifikuar
7. “BOLT” SHPK.	19.535.100 lekë, kualifikuar
8. “Selvije Abasllari” p.f.	19.679.250 lekë, skualifikuar
9. “Muça” SHPK	19.738.700 lekë, kualifikuar

II.4. Në datën 09.04.2021 operatori ekonomik “Erzeni Sh” SHPK. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

*[...]Operatori Ekonomik ERZENI/SH me vlere te ofertes 15.367.000 lekë nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentet e tenderit, konkretisht:*

*Ne shtojcen 9 të Dokumenteve të Tenderit “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT”, Operatori Ekonomik nuk plotëson Kërkesën e Përgjithshme për Kualifikim lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore, pasi bazuar ne vërtetimin Nr.351 Prot, Datë 25.02.2021 lëshuar nga organet e tatim-taksave, rezulton se ka detyrime tatimore ne shumën 6.721.354 lekë për të cilat është lidhur marrëveshja me këste Nr.9398/2 Prot, Datë 03.12.2020.*

*Gjithashtu, nga vërtetimi i gjeneruar nga sistemi elektronik Nr.T03830161, Datë,02.04.2021 i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore rezulton se ka detyrime tatimore te papaguara. Operatori Ekonomik nuk e permbush kriterin e kerkuar pasi rezulton me detyrime.*

*Bashkëngjitur vërtetimi Nr.351 Prot, Datë 25.02.2021, vertetimi elektronik Nr.T03830161, Datë,02.04.2021 dhe Marrëveshja Nr. 9398/2 Prot, Datë 03.02.2020.*

*KVO vendos që ofertuesi ERZENI/SH të mos kualifikohet.*

II.4.1. Në datën 15.04.2021 operatori ekonomik “Erzeni Sh” SHPK. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike. Konkretisht, operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij pranë autoritetit kontraktor pretendon si më poshtë:  
*[...]Operatori ekonomik “Erzeni Sh” ShPK të cilin unë përfaqësoj ka marrë pjesë në procedurën tenderuese me të dhënat e sipërcituara, duke hedhur në sistem të gjithë dokumentacionin si dhe*

duke bërë deklaratë sipas kërkesave të AK-së përcaktuar në Kriteret e Veçanta dhe të Përgjithshme të DST. Ndër dokumentacionet apo deklaratat e kërkuara në procedurë janë ato që lidhen me pagimin e detyrimeve apo mospasjen e detyrimeve ndaj taksave dhe tatimeve . Pikërisht për këtë kërkesë ne kemi hedhur në spe Shtojca 8, Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme, akt marrëveshje për pagimin me këste të detyrimeve tatimore nr. 9398/2 dt. 03.12.2020, mandat pagesë kësti i parë 04.01.2021, mandat kësti i dytë 05.02.2021, mandat pagese kësti i tretë datë 05.03.2021, vërtetim nga shërbimi i tatim pagesve të mëdhenj nr. 351 datë 25.02.2021.

Edhe pse kemi paraqitur këto dokumente “Erzeni Sh” ShPK është skualifikuar nga AK-ja me vlerësimin e datës 09.04.2021 në kundërshtim me bazën ligjore ku thuhet:

Ligji 162 neni 76 i sipërcituar

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë.

Sikurse citon neni respektiv i ligjit pasja e një marrëveshje përbën rast përjashtues për kushtet e skualifikimit të shoqërive debitore nga procedurat tenderuese.

Edhe pse jemi në kushtet e kësaj baze ligjore ne si shoqëri jemi skualifikuar nga AK.

Kjo ka ndodhur edhe pse në vërtetimin e DPT Mëdhenj ( si më poshtë me nënvizim deri në datën kur është marrë ky vërtetim ne konsiderohemi se nuk kemi asnjë detyrim tatimor ne.....

Referojmë vërtetimin nr. 351prot datë 25.02.2021[...]

Sa më sipër skualifikimi i bërë nga AK-ja për subjektin tonë dhe arsyeja mbi të cilën është mbështetur ky skualifikim nuk qëndrojnë sepse:

Erzeni sh ShPK detyrimet e tij i ka rregulluar me marrëveshje dypalëshe dhe deri në këtë moment ka respektuar aktmarrëveshjen. Kompania mund të konsiderohet subjekt me detyrime kur:

Mungon marrëveshja

Nuk respektohet marrëveshja për pagesën me këste.

Do të ishte mire që ju si institucion të thelloheshit më shumë me bazën ligjore ekzistuese apo edhe ti drejtoheshit për konfirmim debitor apo jo Drejtorisë së Tatim pagesve të Mëdhenj nën juridiksionin e së cilës ne jemi si subjekt.

Sa më sipër kërkojmë anulimin e vendimit tuaj për skualifikimin e subjektit Erzeni Sh ShPK nga gara dhe shpalljen fitues . Ndërkohë ne si subjekt i jemi drejtuar me kërkesë Drejtorisë së respektive të Tatimeve nga e cila presim edhe njëherë përsëri vërtetimin për përcaktimin debitor apo jo të subjektit Erzeni Sh ShPK[...].bashkëlidhur njoftim debitimi datë 05.03.2021, Akt marrëveshje nr. 9398/2 prot datë 03.02.2020, vërtetim nr. 351 prot datë 25.02.2021, marrëveshje nr. 9398/1prot datë 03.12.2020, njoftim debitimi datë 04.01.2021, njoftim debiti datë 05.02.2021, njoftim debiti datë 05.04.2021[...]

II.4.2. Në datën 20.04.2021, me shkresën nr. 1015/8 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar ankesën e tij në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht autoriteti kontraktor ka argumentuar:

[...]Referuar dokumentacionit të ndodhur në spe të APP-së dhe në dosjen e procedurës komisioni vlerësoi se pretendimet e ngritura në ankim nuk qëndrojnë. Nga ana juaj nuk është plotësuar kriteri i veçantë i kualifikimit i përcaktuar në shtojcën 8 të DST. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka paguar të gjitha detyrimet ndaj tatim taksave. Komisioni vlerëson se ju keni detyrime tatim-fitimi në shumën 6.721.354 lekë për të cilin është lidhur akt marrëveshje me nr. 9398/2prot datë 03.12.2020, për pagesën me këste. Ky fakt është pranuar edhe nga ana juaj në ankim. Bazuar në kriteret e kualifikimit të publikuara del se përveç kriterëve të tjera të publikuara duhet të plotësonit kriterin, kushtin se keni paguar të gjitha detyrimet e tatimeve, sipas legjislacionit në fuqi. Të qenit debitor ndaj tatim taksave sjell që ju të bëheni i pabesueshëm se do të jeni korrekt në realizimin e kontratës së shërbimeve publike. Për sa kohë keni detyrime ndaj taksave nuk mund të përfitonit nga financat publike.

Ndodhur në këto kushte vendimi i KVO-së për skualifikimin tuaj është i drejtë.

KSHA-ja vlerëson se vendimi i KVO-së është i drejtë dhe i mbështetur në aktet ligjore në fuqi dhe konform kriterëve të kërkuara në DST. Për sa trajtuam më sipër ju bëjmë me dije se ankesa juaj është rrëzuar nga KSHA. Gjithashtu ju bëjmë me dije se dhe Titullari i Bashkisë Durrës mbështet vendimin e marrë nga KSHA-ja për rastin tuaj[...]

II.4.3. Në datën 26.04.2021 operatori ekonomik “Erzeni Sh” SHPK. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 09.04.2021 operatori ekonomik “Emko” SHPK. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.5.1. Në datën 15.04.2021 operatori ekonomik “Emko” SHPK. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Murati D” SHPK me arsyetimin si më poshtë:

[...]Operatori ekonomik “Emko” SHPK ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje për shkolla kopshte” me fond limit 20.832.000 lekë pa TVSH të zhvilluar në datën 16.03.2021 nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës. Në datën 09.04.2021 jemi njohur me njoftimin për klasifikimin përfundimtar të ofertave sipas të cilit rezulton se autoriteti kontraktor ka kualifikuar në vendin e parë operatorin ekonomik “Murati D” SHPK me ofertë ekonomike 15.458.625 lekë pa TVSH. Duke mos qenë dakord me njoftimin e klasifikimit të ofertave po paraqesim formularin e ankesës pranë autoritetit kontraktor brenda afateve ligjore që parashikon neni 63 i LPP-së. Operatori ekonomik “Murati D” SHPK nuk plotëson kriterin e pikës 3 të kapacitetit teknik të DT:

f)Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 8’000’000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

*- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.*

*Operatori ekonomik “Murati D” ShPK nuk e përmbush kriterin e mësipërm pasi nuk ka dorëzuar dokumentacionin që provon se ka kryer furnizime të ngjashme në masën 80.000.000lekë pa TVSH të realizuar në tre vitet e fundit.*

*Operatori ekonomik Murati D ShPK nuk ka dorëzuar dokumentacionin që të provojë likuidimin e detyrimeve ndaj pushtetit vendor për vitin 2020 për secilën nga adresat ku operatori ekonomik ushtron veprimtari sipas ekstraktit tregtar të lëshuar nga QKB.*

*Operatori ekonomik “Murati D” ShPK nuk plotëson kriterin e shkronjës “e” Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

*Nuk ka dorëzuar vërtetimin që provon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri konkretisht operatori ekonomik nuk ka likuiduar detyrimet e muajt Janar 2021 të cilat janë maturuar për pagesë në datën 28.02.2021.*

*Operatori ekonomik Murati D ShPK nuk ka dorëzuar shtojcën 6 Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimin sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar në dokumentet e tenderit.*

*Për sa parashtruar më sipër kërkojmë:*

*Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik Murati D ShPK duke e skualifikuar atë.[...]*

II.5.2. Në datën 20.04.2021, me shkresën nr. 1015/11 prot, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar ankesën në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit. Koncretisht autoriteti kontraktor në kthim përgjigje ka argumentuar:

*[...]A. Operatori ekonomik “Murati D” ShPK nuk plotëson kriterin e pikës 2.3. të kapacitetit teknik të dt ku thuhet se*

*23. Për kapacitetin teknik:*

*f)Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 8’000’000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.*

*- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.*

*Ky pretendim nuk qëndron pasi operatori ekonomik Murati D ka përmbushur kriterin e mësipërm duke dorëzuar dokumentacionin që provon se ka kryer furnizime të ngjashme në masën 8.000.000 lekë pa TVSH në tre vitet e fundit.*

*B. Operatori ekonomik Murati d nuk ka dorëzuar dokumentacion që të provojë likuidimin e detyrimeve ndaj pushtetit vendor për vitin 2020 për secilën nga adresat ku operatori ekonomik ushtron veprimtari sipas ekstraktit tregtar të lëshuar nga QKB.*

*Pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi operatori ekonomik Murati D ka dorëzuar vërtetimin përkatës nëpërmjet të cilit vërtetohet se subjekti Murati D ShPK me NIPT K42003004T ka likuiduar detyrimet vendore deri në vitin 2020.*

*C. Operatori ekonomik “Murati D” ShPK nuk plotëson kriterin e shkronjës “e” Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, konkretisht nuk ka likuiduar detyrimet e muajit Janar 2021 të cilat janë maturuar për pagesë në datën 28.02.2021.*

*Pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi operatori ekonomik Murati D ka dorëzuar vërtetimin përkatës nëpërmjet të cilit vërtetohet se subjekti Murati D ShPK rezulton të ketë në total 0 detyrime për faturat e energjisë elektrike vlerë e përllogaritur deri në datën 26.02.2021 duke përfshirë faturën koherente të muajit Janar 2021.*

*Ç. Operatori ekonomik Murati D ShPK nuk ka dorëzuar shtojcën 6 Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimin sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar në dokumentet e tenderit.*

*Lidhur me këtë pretendim nga verifikimi i dokumentacionit ndodhur në sistemin elektronik rezulton se operatori ekonomik “Murati D” ShPK ka dorëzuar shtojcën 6.*

*Për sa më sipër ankesa juaj refuzohet. Titullari i Bashkisë Durrës mbështet vendimin e KSHA-së [...]*

II.5.3. Në datën 27.04.2021 operatori ekonomik “Emko” SHPK. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

[...]

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 1015/13 prot., datë 06.05.2021, protokolluar me tonën në datën 10.05.2021 me objekt: “Dërgohet informacioni për vendimin nr. 699/1”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Erzeni SH” ShPK, për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, me arsyen se: “[...]Operatori Ekonomik ERZENI/SH me vlere te ofertës 15.367.000 lekë nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në

*dokumentet e tenderit, konkretisht: Ne shtojcen 9 të Dokumenteve të Tenderit “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT ”, Operatori Ekonomik nuk plotëson Kërkesën e Përgjithshme për Kualifikim lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore, pasi bazuar ne vërtetimin Nr.351 Prot, Datë 25.02.2021 lëshuar nga organet e tatim-taksave, rezulton se ka detyrime tatimore ne shumën 6.721.354 lekë për të cilat është lidhur marrëveshja me këste Nr.9398/2 Prot, Datë 03.12.2020.*

*Gjithashtu, nga vërtetimi i gjeneruar nga sistemi elektronik Nr.T03830161, Datë,02.04.2021 i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore rezulton se ka detyrime tatimore te papaguara. Operatori Ekonomik nuk e përmbush kriterin e kërkuar pasi rezulton me detyrime. Bashkëngjitur vërtetimi Nr.351 Prot, Datë 25.02.2021, vërtetimi elektronik Nr.T03830161, Datë,02.04.2021 dhe Marrëveshja Nr. 9398/2 Prot, Datë 03.02.2020.*

*KVO vendos që ofertuesi ERZENI/SH të mos kualifikohet.”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 9 “kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”, gërma “d” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

*d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të kriterit sa më sipër, rezulton se operatori ekonomik “ERZENI/SH “ShPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

*Shtojca 8, Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme*

*Akt marrëveshje për pagimin me këste të detyrimeve tatimore nr. 9398/2 dt. 03.12.2020*

*Mandat pagesë datë 04.01.2021*

*Mandat pagesë datë 05.02.2021*

*Mandat pagesë datë 05.03.2021,*

*Vërtetimin 351 datë 25.02.2021 për detyrimet fiskale e sigurimet shoqërore” lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nga ku rezulton se shoqëria “Erzeni SH” SHPK ka detyrime tatimore [...]*

- 1. Tatim mbi të fitimin në shumën 6.721.354 lekë për të cilën është lidhur aktmarrëveshja për pagesë me këste me nr. 9398/2prot datë 03.12.2020*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.1.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një*



*ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008, *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i cili në nenin 6/3 parashikon se: *“Me detyrim tatimor” nënkupton “tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”*.

III.1.7. Referuar sa më sipër Komisioni konstaton se, në kriterin e vendosur në dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës që të deklarojnë se (subjekti) ka paguar të gjitha detyrimet e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Erzeni SH” SHPK., KPP konstaton se ky i fundit krahas Shtojcës 8, Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme ka dorëzuar edhe dokumentacionin konkretisht: Akt marrëveshje për pagimin me këste të detyrimeve tatimore nr. 9398/2 dt. 03.12.2020, Mandat pagesë datë 04.01.2021, Mandat pagesë datë 05.02.2021, Mandat pagesë datë 05.03.2021, Vërtetimin 351 datë 25.02.2021 për detyrimet fiskale e sigurimet shoqërore” lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nga ku rezulton se shoqëria “Erzeni SH” SHPK ka detyrime *“[...] Tatim mbi të fitimin në shumën 6.721.354 lekë për të cilën është lidhur aktmarrëveshja për pagesë me këste me nr. 9398/2prot datë 03.12.2020[...]”*. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, duke qenë se operatori ekonomik ankimues, referuar Vërtetimit Nr. 351 datë 25.02.2021, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rezulton të ketë detyrime, përkatësisht për zërin *“Tatim mbi të fitimin”*, skualifikimi i tij nga kjo procedurë prokurimi, prej autoritetit kontraktor është tërësisht i bazuar. Në vetvete akt-marrëveshja me Drejtorinë Rajonale Tatimore, është njohje dhe pranim i detyrimit, nga ana e operatorit ekonomik ankimues, që për shkaqe të ndryshme, nuk ka mundur ti përmbushë ato në kohë. Organi i Administratës Tatimore me anë të Akt- Marrëveshjes, ka lejuar pagesën me këste të detyrimeve deri në muajin Qershor të vitit 2021, duke i krijuar lehtësi operatorit për përmbushjen e detyrimeve fiskale. Paraqitja e Akt- Marrëveshjes, nga ana e operatorit ekonomik ankimues, nuk mund të konsiderohet se përmbush kriterin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në shtojcën 9 të Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit *“Për shlyerjen e detyrimeve fiskale”*, pasi detyrimi konsiderohet i papërmbushur deri në momentin e pagesës së kështit të fundit, i cili sipas Akt -Marrëveshjes përkon me muajin Qershor të vitit 2021. Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore sipërcituar, duke skualifikuar operatorin ekonomik “Erzeni SH” SHPK.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Emko” SHPK mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Murati D” SHPK , në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se “Operatori ekonomik Murati D ShPK nuk ka dorëzuar shtojcën 6 Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar në dokumentet e tenderit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 6 “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit”, përcaktohet:

*Shtojca 6*

*[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]*

**DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE REALIZIMIN E  
OBJEKTIT SIPAS GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

*Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.*

*Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e \_\_\_\_\_ të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj se:*

*Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumente (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.*

*Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_*

*Përfaqësuesi i ofertuesit*

*Nënshkrimi*

*Vula*

III.2.2. Në shtojcën 9 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” pika . 2 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:*

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;
- c. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;
- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

III.2.3. Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik rezulton se në përmbushje të kriterit të mësipërm në sistemin e prokurimeve elektronike është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

#### *DEKLARATE MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*

*Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë 16.03.2021 nga Autoriteti Kontraktor: “Bashkia Durrës” me objekt: ““Blerje pajisje për shkolla kopshte” me fondin limit : 20’832’000 Lekë pa TVSH.*

*Unë i nënshkruari Dervish Murati me cilësinë e Administratorit të operatorit ekonomik “Murati D” ShPK deklaroj se:*

*Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumente (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.*

*Data e dorëzimit të deklaratës: 16.03.2021*

*Përfaqësuesi i ofertuesit*

*Nënshkrimi i ofertuesit*

*Vula*

III.2.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Murati D” ShPK nuk e ka dorëzuar shtojcën 6 “Deklaratë mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike dhe Realizimin e Objektivit sipas Grafikut të Lëvrimin” sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga autoriteti kontraktor.

III.2.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.2.6. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, në pjesën *“Udhëzime për operatorët ekonomikë”* Seksioni 1 përcaktohet se: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.*

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, KPP vëren se, në Shtojcën X të dokumenteve të tenderit, shtojcë e cila është e detyrueshme për t'u plotësuar nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, është kërkuar të vetëdeklarohet në lidhje me:

- *Përmbushjen e Specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga operatorët ekonomik.*
- *Marrjen përsipër nga ana e operatorëve ekonomik të realizimit të objektit sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.*

III.2.8. Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Emko” ShPK , KPP pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik “Murati D” ShPK *“Deklaratë mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike”*, si dhe shqyrtimit të shtojcës nr. 6 *“Deklaratë mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike dhe Realizimin e Objektit sipas Grafikut të Lëvrimit”*, të publikuar në setin e dokumenteve standarde të tenderit nga autoriteti kontraktor, konstatohet se shtojca 6 e dorëzuar nga operatori ekonomik “Murati D”, ShPK nuk është plotësuar sipas shtojcës 6 të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde, ku operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me dokumentet e tenderit të publikuara nga autoriteti kontraktor do të refuzohen si të papranueshme.

III.2.9. Komisioni konstaton gjithashtu se në shtojcën 6 të dorëzuar nga operatori ekonomik “Murati D” ShPK, mungon paragrafi që i referohet *“Marrjes përsipër të realizimit të objektit sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor”*, duke mos plotësuar kështu kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 9/2/1 gërma “ç” *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”* ku përcaktohet se: *“Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas shtojcës 6”*, ndërkohë në seksionin nr. 1 *“Udhëzime për operatorët ekonomikë”*, *“Hartimi i ofertës”* pika 1.1. përcaktohet se: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.”*. Nga sa më sipër rezulton se këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e deklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 6”. Komisioni gjykon se plotësimi i shtojcës nr. 6, duhet të bëhet duke respektuar formatin e dokumenteve të tenderit të procedurës objekt prokurimi. Operatorët ekonomikë kanë detyrimin që të plotësojnë këtë dokument duke deklaruar të dhënat e kërkuara në

lidhje me përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi si dhe më e rëndësishmja marrja përsipër e realizimit të objektit të prokurimit sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor”. Komisioni gjykon se këto të dhëna deklaruese janë të rëndësishme dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për tu garantuar në lidhje me kryerjen me sukses të kontratës dhe sipas grafikut të lëvrimit që ka përcaktuar vetë autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit.

III.2.10. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Nga sa më sipër, operatori ekonomik “Murati D” ShPK ka dështuar të përmbushë kërkesën e AK-s në lidhje me plotësimin e “*Deklaratës mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike dhe Realizimin e Objektit sipas Grafikut të Lëvrimit* e cila duhej plotësuar me dorëzimin e deklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 6”, sepse mungon paragrafi që i referohet “*marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor*”, duke bërë kështu që shtojca 6 “*Deklarata mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike dhe Realizimin e Objektit sipas Grafikut të Lëvrimit*”, të këtë mangësi në një nga elementët e vetëdeklarimit, duke mos respektuar në këtë mënyrë formatin e dokumenteve të tenderit të procedurës objekt prokurimi, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik e të publikuara në SPE nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të nenit 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumenteve të tenderit do të refuzohet. Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues nuk ka ofertuar sipas shtojcës 6 “*Deklarata mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike dhe Realizimin e Objektit sipas Grafikut të Lëvrimit*” të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: “*Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*”; “*Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve*”, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues “Murati D” ShPK duhet të kishte plotësuar shtojcën 6 “*Deklarata mbi Përmbushjen e*

*Specifikimeve Teknike dhe Realizimin e Objektivit sipas Grafikut të Lëvrimit*” sipas dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.2.11. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar parashikohet se “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni*”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues “Murati D” ShPK do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt ankimi.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Emko” ShPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Emko” ShPK ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Murati D” ShPK, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për sa kohë që pretendimi i mësipërm qëndron dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të operatorit ekonomik “Murati D” ShPK., e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Erzeni/SH” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me nr. REF-87615-02-18-2021, me objekt “Blerje pajisje për shkolla kopshte” me fondin limit : 20’832’000 Lekë pa TVSH , zhvilluar në datën 16.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Emko” ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Murati D” ShPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Emko” ShPK.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 699 Protokolli**

**Datë 26.04.2021**

**Nr. 706 Protokolli**

**Datë 27.04.2021**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**

**Lindita Skeja**

**Anëtar**

**Merita Zeqaj**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**